



OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Nr. _____ Prot.,

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Riparim mirëmbajtje e Sistemit të Kondicionimit për 24 Muaj”, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore, Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, të ndarë në lote si më poshtë vijon:

Loti I: “Riparim mirëmbajtje e Sistemit të Kondicionimit për 24 Muaj”, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore, Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.-Njësia Tiranë.

Loti II: “Riparim mirëmbajtje e Sistemit të Kondicionimit për 24 Muaj”, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore, Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.-Njësia Kavaje.

FONDI LIMIT : 13,989,639.11 (trembëdhjetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH.

Loti I: me fond limit: **11,896,972.44** (njëmbëdhjetë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e dy pikë dyzetë e katër) lekë pa TVSH

Loti II: me fond limit: **2,092,666.67** (dy milion e nëntëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH

PROCEDURA: E Hapur

AFATI: Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara me afat 24 muaj.

Shërbime të ndryshme për riparim dhe mirëmbajtje : Riparime dhe mirëmbajtje impiantesh
45259000-7

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjit Nr.9863 datë 28.01.2008 “Për ushqimin” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Operatori i Blerje të Përqëndruara sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar.

Sipas parashikimeve ligjore për procedurat të cilat realizohen nga Organi Qëndror Blerës, Specifikimet Teknike, Termat E Referencës dhe llogaritja e Fondit Limit përcillen nga Autoritete Kontraktore të cilat kërkojnë shërbimin.

Shtojca 8-Kriteret e Vecanta për Kualifikim është hartuar si vijon:

Loti I: “Riparim mirëmbajtje e Sistemit të Kondicionimit për 24 Muaj”, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore, Q.S.R.T “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.-Njësia Tiranë.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

- **NS12-A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.**

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4, gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) “ose ekuivalent; (të vlefshme) ose ekuivalentet e tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.
- SSH/EN/ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;

Argumentimi: Bazuar në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021, neni 44 “Kërkesat e cilësisë” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Kriteri që OE duhet të disponojë Certifikate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron. OHSAS 18001/ISO 45001 – Shëndeti dhe Siguria në Punë. Standardi ISO 45001 specifikon kërkesat për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Ai fokusohet në kontrollin efektiv të të gjitha risqeve profesionale për të gjitha palët e interesuara (punonjësit, vizitorët, furnitorët, komuniteti lokal, etj.), dhe në përmirësimin e performancës së përgjithshme të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. ISO 45001 është krijuar për të mbuluar shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe jo sigurinë e produkteve ose proceseve.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/b dhe 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetin financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasinë e shërbimeve të realizuara.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41, pika 3 VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Prvoja e ngjashme është një siguri që operatorët ekonomik kanë eksperiencë për zbatimin e kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik për këtë objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2024**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Licencë për Drejtues Teknik
- Diplomë
- Kontratë pune e vlefshme

Në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik të punësuar jo më pak se **8 (tetë)** punonjës, për instalimin dhe shërbimin e mirëmbajtjes së sistemeve në fushën objekt prokurimi, të siguruar për periudhën Prill të vitit 2024, sipas profileve të mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Inxhinier Elektrik	1
2.	Inxhinier Mekanik	1
3.	Elektracist	2
4.	Specialist per sistemet ngrohje/ftohje	3

Në fazën e ofertimit, për punonjësit, të plotësohet në vetëdeklarimin sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, duhet të paraqiten dokumentat:

1. Për Inxhinier Elektrik:

- Diplomë
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo më pak se një vit.

2. Për Inxhinier Mekanik:

- Diplomë
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo më pak se një vit.

Për punonjësit në pikën 3, 4,5, të tabelës kërkohet:

- Diplomë/Certifikatë/ Dëshmi për kualifikimin/ trajnimin.
- Kontratat individuale të Punës vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
- Librezë pune.
- Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën **Prill 2024**, të konfirmuara nga administrata tatimore.
- Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, për periudhën **Prill 2024**.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët

ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41, pika 4 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjes pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shënim:

Argumentim: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat e rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuese, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për jashtëm nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Loti II: “Riparim mirëmbajtje e Sistemit të Kondicionimit për 24 Muaj”, për mbulimin e nevojave për një periudhë 24 mujore, Q.S.R.T “Shefqet Ndoqi”, Tiranë.-Njësia Kavaje.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:

- **NS12-A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.**

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 4 , gërma a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencën profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të kenë kryer ekuivalentimin (*njehsimin*) e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë kompetente të ngarkuar me ligj në Republikën e Shqipërisë.

Operatori/et ekonomik duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, për objektin që prokurohet, të cilat duhet të jenë të perkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara, sipas standardeve:

- SSH/EN/ISO 9001:2015 mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë (të vlefshme) “ose ekuivalent; (të vlefshme) ose ekuivalentet e tij të sistemit të menaxhimit të cilësisë. Qëllimi i certifikimit të kompanisë duhet të jetë sipas objektit që do të prokurohet.
- SSH/EN/ ISO 45001-2018 mbi “Sistemin e menaxhimit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalent;

Argumentimi: Bazuar në VKM Nr. 285 date 19.05.2021, neni 44 “Kërkesat e cilësisë” Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. Kriteri që OE duhet të disponojë Certificate ISO 9001-2015 ose ekuivalente me të, “Për sistemin e menaxhimit të cilësisë”, është kërkuar për të siguruar që OE disponon një sistem të organizuar të menaxhimit të cilësisë së shërbimit që ofron. OHSAS 18001/ISO 45001 – Shëndeti dhe Siguria në Punë. Standardi ISO 45001 specifikon kërkesat për zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë. Ai fokusohet në kontrollin efektiv të të gjitha risqeve profesionale për të gjitha palët e interesuara (punonjësit, vizitorët, furnitorët, komuniteti lokal, etj.), dhe në përmirësimin e performancës së përgjithshme të shëndetit dhe sigurisë në vendin e punës. ISO 45001 është krijuar për të mbuluar shëndetin dhe sigurinë në punë, dhe jo sigurinë e produkteve ose proceseve.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, sipas nenit 74 të secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaramentit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% e vlerës së përlllogaritur të kontratës. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 2/c dhe 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP; të nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitetet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e publikimit të njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- c) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- d) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentim: Kriteri vendoset bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 41, pika 3 VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Prvoja e ngjashme është një siguri që operatorët ekonomik kanë eksperiencë për zbatimin e kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik për këtë objekt prokurimi, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera, të figurojë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Prill 2024**, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Licencë për Drejtues Teknik
- Diplomë
- Kontratë pune e vlefshme

Në rastin e bashkimit të operatorëve secili operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik të punësuar jo më pak se **5 (pesë)** punonjës, për instalimin dhe shërbimin e mirëmbajtjes së sistemeve në fushën objekt prokurimi, të siguruar për periudhën Prill të vitit 2024, sipas profileve të mëposhtme:

Nr.	Profesioni	Numri i punonjesve
1	Inxhinier Elektrik	1
2.	Inxhinier Mekanik	1

3.	Elektracist	1
4.	Specialist per sistemet ngrohje/ftohje	1

Në fazën e ofertimit, për punonjësit, të plotësohet në vetëdeklarimin sipas Shtojcës 9, ndërsa në rast të kualifikimit, përpara shpalljes së fituesit paraprak, duhet të paraqiten dokumentat:

3. Për Inxhinier Elektrik:

- Diplomë
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo më pak se një vit.

4. Për Inxhinier Mekanik:

- Diplomë
- Kontratë pune,
- Librezë pune ose çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën jo më pak se një vit.

Për punonjësit në pikën 3, 4,5, të tabelës kërkohet:

- a) Diplomë/Certifikatë/ Dëshmi për kualifikimin/ trajnimin.
- b) Kontratat individuale të Punës vlefshme në kohën e zhvillimit te procedurës.
- c) Librezë pune.
- d) Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën **Prill 2024**, të konfirmuara nga administrata tatimore.
- e) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, për periudhën **Prill 2024**.

Argumentimi: Spas Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar Neni 77 Kërkesat për kualifikim, pika 4 Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

VKM Nr. 285, date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 41, pika 4 Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c)fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- 1 (një) punonjes pergjegjes per sigurine dhe shendetin ne pune, i cili të jetë i çertifikuar “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë” në përputhje me klauzolat e ligjit nr.10327 date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”.

Ndersa operatori ekonomik fitues duhet te dorezoje prane AK, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Shënim:

Argumentim: Kriteri për punonjësit vendoset nga një analizë e specifikimeve teknike, grafikut të ekzekutimit të kontratës dhe termave të referencës, hartuar nga AK.

Shënim: Rastet kur konstatohen deklaratat të rreme, të paraqitura nga operatorët ekonomik në përmbushje të kriterëve kualifikuesë, do të konsiderohen si kusht për skualifikim, si dhe do të ndiqet procedura për përjashtim nga Agjencia e Prokurimit Publik.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.